

KONTRATË PER SHITBLERJEN E KUOTAVE TË KAPITALIT

Në Tiranë, sot, më datë 28.01.2019, nënshkruhet kjo kontratë ndërmjet palëve të mëposhtme:

- **Z. Ermal Sallaku**, shtetas shqiptar, lindur me 25.09.1986, në Tirane, Shqipëri, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, banues në Rruga Ferit Xhajko, Pallati 57/1, Apartamenti 6, Tirane, Shqiperi, Zip 1037, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 024616465 dhe Nr. personal I60925040K.

(për efekt të kësaj kontrate këtu e më poshtë referuar si "**Shitësi**")

dhe

- **Z. Redi Haxhi**, shtetas shqiptar, lindur me 20.05.1977, në Bilisht, Devoll, Shqipëri, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, banues në Rruga Abdi Toptani (për efekt të kësaj kontrate këtu e më poshtë referuar si "**Blerësi**")

Për efekt të kësaj kontrate, këtu e në vazhdim, secila referuar si "Pala" dhe së bashku referuar si "Palët".

BAZA LIGJORE: Bazuar në nenin 705 e vijues të Kodit Civil si dhe në nenin 73 e vijues të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

Duke qenë se :

- A. Shoqëria "Introvus Solutions" sh.p.k. (këtu e më poshtë referuar si "Shoqëria") është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, më datë 23.01.2019, me NUIS L91323013Q, me seli në Rruga e Kavajes, Hyrja -1, me numer pasurie 4/245-N24, prane GKAM, Tiranë, me kapital të regjistruar dhe térësisht të paguar prej 10.000 (dhjetemijë) lekë, i ndarë në dy kuota.
- B. Shitësi eshte Ortak i cili zoteron një kuotë me vlerë nominale përkatësisht:
 - Z.Ermal Sallaku 3,000 (tremijë) lekë, që përfaqëson 30% te kapitalit te regjistruar te shoqerise.
- C. Blerësi bie dakord të blejë një pjese se kuotes në përqindjen e përcaktuar në këtë kontratë, duke fituar të drejtat që rrjedhin nga kuotat, sipas Statutit të Shoqërisë dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- D. Shitësi bien dakord të transferojet një pjese te kuotes te Blerësi, sipas përqindjes së përcaktuar në këtë kontratë, në përputhje me afatet dhe kushtet e kësaj kontrate.

ATËHERE:

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Ermal Sallaku".A handwritten signature in black ink, appearing to read "Redi Haxhi".
1/4

Palët, me vullnet të lirë dhe të plotë, bien dakord për nënshkrimin e kësaj Kontrate për shitblerjen e kuotave të kapitalit të shoqërisë "Introvus Solutions" sh.p.k" (këtu e më poshtë referuar si "Kontrata"), sipas klauzolave si vijon:

Neni 1 Objekti i Kontratës

- 1.1 Shoqëria "Introvus Solutions" sh.p.k, me Vendim të Asamblese së Përgjithshme të Ortakëve, ka vendosur në mënyrë unanime, miratimin e shitjes së një pjese te kuotes që përbëjnë 5% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, të zotëruar nga Shitësi si më poshtë:
- Shitësi Z. Ermal Sallaku i shet Blerësit një pjese te kuotës se zotëruar prej tij në kapitalin e regjistruar të shoqërisë, me vlerë nominale 500 lekë (peseqind).

Neni 2 Çmimi i shitjes dhe mënyra e pagesës


- 2.1 Cmimi i shitjes është 500 lekë.
- 2.2 Blerësi bie dakord t'i paguajë Shitësve çmimin për shitblerjen e kuotava brenda 5 (pesë) ditëve nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate, në llogaritë bankare përkatëse të Shitësve, sipas vlerave korresponduese.

Neni 3 Transferimi i Pronësisë

- 3.1 Pronësia mbi një pjese te kuotes se kapitalit, objekt i kësaj Kontrate, transferohet nga Shitësi te Blerësit, në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate.
- 3.2 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Shitësit zhvishet nga e drejta që rrjedhin nga pronësia mbi pjesen e transferuar te kuotes dhe këto të drejta kalojnë te Blerësi, në përputhje me klauzolat e kësaj Kontrate, legjislacionin shqiptar në fuqi dhe Statutin e Shoqërisë.

Neni 4 Deklarime dhe Garanci

- 4.1 Shitësi deklaron dhe garanto Blerësin si vijon:
- a) Shitësi zotëron kuotat të lira nga çdo barrë siguruese, peng, hipotekë, garanci pagese, barrë mbi interesat, apo angazhime të tjera të çdo lloji (secila më poshtë referuar si "Barrë");
 - b) Pjesa e shitur e Kuotes se shitur nga Shitësi, në përputhje me këtë Kontratë, në momentin e transferimit të pronësisë te Blerësi, sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate, do të jenë të lira nga çdo barrë dhe do të regjistrohen rregullisht në emër të Blerësit në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me parashikimet e legjislacionit shqiptar në fuqi.
 - c) Nënshkrimi i kësaj Kontrate dhe plotësimi nga Shitësi i kushteve dhe klauzolave të kësaj Kontrate, nuk bien në kundërshtim ose nuk përbëjnë shkelje të ndonjë kushti apo dispozite të: (i) Aktit të Themelimit, Statutit apo rregulloreve të tjera të Shoqërisë « Introvus Solutions" sh.p.k" sh.p.k., të nënshkruara dhe miratuara rregullisht nga Shitësit; (ii) ndonjë

A photograph of two handwritten signatures in black ink. The signature on the left appears to be "Ermal Sallaku". The signature on the right is less distinct but appears to be "Shitësi". To the far right of the signatures, the number "2/4" is handwritten.

- gjykimi, urdhëri, vendimi gjyqësor, dekreti ose vendimi të çdo gjykate apo autoriteti shtetëror, vendas apo të huaj, subjekt i të cilët janë Shitësit apo Shoqëria "Introvus Solutions" sh.p.k" sh.p.k.; (iii) ndonjë marrëveshje, licencë, ose angazhimi në të cilin Shitësit apo Shoqëria "Introvus Solutions" sh.p.k. është palë, që do të cënonte aftësinë e Shitësit për të nënshkruar apo përbushur detyrimet që rrjedhin nga Kontrata ose (iv) me ligjin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.
- d) Blerësi është njohur me gjendjen financiare dhe Statutin e Shoqërisë Introvus Solutions" sh.p.k sh.p.k., dhe nuk ka asnë pretendim të tanishëm dhe/ose të ardhshëm ndaj Shitësve në lidhje me çmimin e shitjes, dhe nëse në të ardhmen do të rezultojë ndonjë ndryshim negativ me natyrë financiare apo i çfarëdo natyre tjetër, që e ka origjinën përparrë datës apo në datën e kësaj Kontrate, Blerësi nuk do të kërkojë nga Shitësit kthimin e çmimit të shitjes apo të ndonjë pjese të tij.

Neni 5 Gjendja përfundimtare e kuotave të Shoqërisë

- 5.1 Pas transferimit të pronësisë, sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate, Shoqëria "Introvus Solutions" sh.p.k do të zoterohet:
- Z.Redi Haxhi do te zoteroje 75% te kapitalit te shoqerise
 - Z.Ermal Sallaku do et zoteroje 25% te kapitalit te shoqerise

Neni 6 Forca Madhore

- 6.1 Mospërbushja e kësaj kontrate, nga ana e njerës prej palëve, nuk do të konsiderohet si shkelje e kësaj kontrate, për sa kohë që kjo mospërbushje vjen si pasojë e një ngjarje të konsideruar Forcë Madhore, në rastin kur provohet se pala e prekur nga kjo ngjarje: (a) ka marrë të gjitha masat e arsyeshme parandaluese, si dhe të gjitha masat e nevojshme për të përbushur kushtet dha afatet e kësaj marrëveshjeje dhe (b) ka informuar palen tjetër në mënyrë të menjëershme për ndodhjen e kësaj ngjarje. Forcë Madhore do të konsiderohet çdo urdhër, rregullore, direktivë e qeverisë, e shpallur në formën e ligjit apo në mënyrë tjerë, ose çdo lloj sankzioni me natyrë kombëtare apo ndërkombëtare, trazirë, kryengritje popullore, luftë (e deklaruar ose jo), akte terroriste ose guerrilase të grupeve apo të inividive të veçantë, greva apo shqetësimë të tjera të punës të kësaj natyre, zjarre, tërmete apo çdo lloj shkaku tjetër, që nuk varet nga vullneti i palëve ose nuk vjen si pasojë e neglizhencës së tyre dhe që ata nuk kishin mundësi ta parashikonin.
- 6.2 Çdo periudhë kohe, brenda së cilës njëra prej palëve, bazuar në këtë Kontratë, duhet të ndërmerrë ndonjë veprim, do të zgjatet në mënyrë të barabartë me periudhën e kohës në të cilën pala e kishte të pamundur të vepronë si pasojë e Forcës Madhore. Në rastin kur ngjarjet e Forcës Madhore zgjasin për më shumë se 3 (tre) muaj pa ndërprerje, Palët do të jenë të lira të zgjidhin në mënyrë të njëanshme, pa asnë penalitet, këtë Kontratë.



3/4

Neni 7
Të ndryshme

- 7.1 Kjo kontratë rregullohet dhe hartohet në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin lidhur me këtë Kontratë do të zgjidhen me mirëkuptim mes Palëve, dhe nese nuk arrihet një zgjidhje, kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 7.2 Kjo Kontratë përbën të gjithë marrëveshjen midis palëve në lidhje me çështjet objekt kontrate. Kjo Kontratë mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet miratimit me shkrim nga Palët.
- 7.3 Kjo marrëveshje nënshkruhet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe, me vlerë të njejtë ligjore secila.
- 7.4 Kjo marrëveshje hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të saj.

Palët, pasi e lexuan me vëmendje këtë Kontratë, e gjejnë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë, të plotë dhe të pavesuar, e nënshkruajnë rregullisht si më poshtë.

SHITËSI

Ermal SALLAKU




BLERËSI

Redi HAXHI
